



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr.2004 / 14

PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE FINANCIARE

Kuvendi i Kosovës,

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/9 mbi Kornizën Kushtetuse për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, kreu 5.1 (a) dhe (b) si dhe kreu 5.6; kreu 8.1 (c), (i), (f) dhe (k); dhe kreu 9.1.26 (a) dhe 9.3.3;

Duke marrë parasysh pjesën IX për kufizimet në huamarrje, garantime, huadhënie dhe kapitalizime, dhe sidomos nenet 44, 45 dhe 46 të Ligjit nr.2003/2 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit dhe duke pasur parasysh nevojën për rregullimin e marrëveshjeve ndërkombëtare financiare dhe garantimin e tyre

Aprovon ligjin si vijon:

LIGJI PËR MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE FINANCIARE

Neni 1

Fushëveprimi dhe përkufizimet

1.1. Ky ligj zbatohet për të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare financiare që nënshkruhen dhe hynë në fuqi pas aprovimit të këtij ligji.

1.2. Në kuptim të këtij ligji, një “marrëveshje ndërkombëtare financiare” nënkupton çdo marrëveshje:

- a. që lidhet për UNMIK-un nga Përfaqësuesi Special për një periudhë kohore prej dy ose më shumë viteve me një ose më shumë shtete, institucione financiare ndërkombëtare dhe/ose organizata tjera ndërkombëtare dhe/ose ndërmarrje të inkorporuara jashtë Kosovës; dhe
- b. dhe që krijon një detyrim qoftë edhe të kushtëzuar, përfshirë aty marrëveshjet për kredi, marrëveshje garantimi, marrëveshje për mbrojtjen e investimeve si dhe instrumentet tjera financiare.

1.3. Ligji 2003/2 nënkupton Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur me Rregulloren nr. 2003/17 të datës 12 maj 2003.

1.4. "PSSP" nënkupton Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

1.5. "UNMIK" nënkupton Misionin e Kombeve të Bashkuara për Administrim të Përkohshëm të Kosovës.

Neni 2

Detyrimet financiare dhe përfashtimi i përgjegjësisë së UNMIK-ut

2.1. Marrëveshjet Ndërkombëtare Financiare përcaktojnë entitetin ose palën e cila është përgjegjëse për të permbushur detyrimet që rezultojnë nga një marrëveshje e tillë.

2.2. Marrëveshjet Ndërkombëtare Financiare që lidhen sipas dispozitave të këtij ligji nuk mund të krijojnë një detyrim financiar, qoftë ky edhe detyrim financiar nën kusht, për UNMIK-un ose për Kombet e Bashkuara. Të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare financiare të lidhura sipas dispozitave të këtij ligji duhet të përcaktojnë saktësisht dhe në mënyrë të qartë se kjo marrëveshje nuk është e garantuar ose në ndonjë mënyrë tjetër e siguruar nga UNMIK-u ose Kombet e Bashkuara.

Neni 3

Procedura

3.1. Delegacioni negociues përbëhet nga tre përfaqësues të UNMIK-ut që emërohen nga PSSP-ja dhe tre përfaqësues të IPVQ-së që miratohen nga Qeveria. Përfaqësuesit e IPVQ-së kryesohen nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave në bashkëpunim të ngushtë me PSSP-në.

3.2. Marrëveshjet Financiare Ndërkombëtare hyjnë në fuqi dhe krijojnë detyrime për Kosovën pas pëlqimit me shkrim të Qeverisë, miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe nënshkrimit të PSSP-së për UNMIK-un. PSSP-ja mund të nënshkruaj një marrëveshje ndërkombëtare financiare vetëm nëse është respektuar procedura e paraparë në paragrafet 3 deri 5.

3.3. Ministri për Ekonomi dhe Financa ia dërgon Qeverisë së Kosovës çdo propozim për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare financiare për miratim. Një kopje e kësaj propozim-marrëveshjeje i dërgohet njëkohësisht edhe PSSP-së.

3.4. Pas miratimit nga Qeveria, propozim-marrëveshja i dërgohet Kuvendit të Kosovës për miratim. Dokumentacioni i dërguar në Kuvend duhet të përmbajë edhe një përmbledhje të informatave që i ka Qeveria si dhe të informatave dhe komenteve tjera të cilat Qeveria mund të vendos t'i dërgoj në Kuvend. Një kopje e këtij dokumentacioni i dërgohet njëkohësisht edhe PSSP-së.

3.5. Pas miratimit nga Kuvendi, propozim-marrëveshja i dërgohet PSSP-së i cili mund:

- a. të nënshkruaj dhe ta lidhë marrëveshjen në mënyrë të plotfuqishme ashtu siç e ka miratuar Kuvendi;
- b. të ndryshoj propozim-marrëveshjen dhe t'ia kthej Qeverisë për rishqyrtim në Qeveri dhe në Kuvend; ose
- c. të refuzoj lidhjen e marrëveshjes së propozuar.

Neni 4
Referenca në Ligjin nr.2003/2

4.1.Pjesa IX e Ligjit nr.2003/2 zbatohet në rast të marrëveshjeve ndërkombëtare financiare, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë ligj.

4.2. Marrëveshjet ndërkombëtare financiare mund të lidhën me çdo person juridik të përcaktuar në nenin 1.2 (a) të këtij ligji si dhe në nenin 46.1 dhe listen B të ligjit nr. 2003/2.

4.3. Neni 19.5 (a) (v) i ligjit nr.2003/2 nuk zbatohet në rast të marrëveshjeve ndërkombëtare financiare të nënshkruara nga PSSP-ja të cilat hyjnë në fuqi gjatë vitit fiskal 2004.

Neni 5
Sukcesioni juridik

Të gjitha detyrimet që rezultojnë nga marrëveshjet financiare ndërkombëtare, përfshirë aty edhe detyrimet e kushtëzuara, i obligojnë IPVQ-të si dhe çdo qeveri ose autoritet tjetër suksesor i cili ushtron pushtet administrativ mbi Kosovën për aq sa mbetet marrëveshja financiare ndërkombëtare në fuqi, përveç nëse kjo marrëveshje nuk thot ndryshe. IPVQ-të marrin obligime vetëm për marrëveshjet që lidhen në bazë të këtij ligji.

Neni 6
Konfliktet ligjore dhe amandamentet

6.1. Nëse dispozitat e një marrëveshjeje ndërkombëtare financiare janë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë, atëherë dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare financiare kanë epërsi ndaj ligjit të zbatueshëm në Kosovë, qoftë ky i tashëm ose i ardhshëm.

6.2. Asnjë ndryshim i këtij ligji nuk zbatohet në raport me një marrëveshje ndërkombëtare financiare të nënshkruar nga PSSP-ja para se ky ndryshim të ketë hyrë në fuqi.

6.3. Asnjë dispozitë e një marrëveshjeje ndërkombëtare financiare nuk mund të anulohet, të ndryshohet ose të shpallet e pavlefshme ose nule përveç nëse

- a. Me pajtimin e palëve pas pranimit të miratimit me shkrim nga Qeveria dhe Kuvendi.;
- b. Përndryshe në përputhshmëri me procedurat dhe kushtet e parashtruara në marrëveshjen financiare ndërkombëtare.

Neni 7 Zgjidhja e kontesteve dhe zgjedhja e ligjit

7.1. Marrëveshjet ndërkombëtare financiare duhet të përmbajnë dispozita për zgjishjën e kontesteve të cilat mund të rezultojnë nga këto marrëveshje. Këto dispozita mund të parashohin arbitrazh ndërkombëtar, marrje të vendimit nga një gjyq i Kosovës ose marrje të vendimit nga një gjyqi të një jurisdiksioni të përcaktuar.

7.2. Duke marrë parasysh nenin 7.1 të këtij ligji, në marrëveshjen ndërkombëtare financiare parashihet arbitrazh ndërkombëtar në pajtim me rregullat e arbitrazhit të pranuar ndërkombëtarisht, si për shembull rregullat e arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të drejtën ndërkombëtare tregtare (UNCITRAL) ose rregullat e arbitrazhit të Qendrës Ndërkombëtare për Zgjedhjen e Kontesteve lidhur me Investime (ICSID).

7.3. Në marrëveshjet ndërkombëtare financiare mund të parashihet që e drejta e zbatueshme e Kosovës ose e drejta e ndonjë jurisdiksioni tjetër jashtë Kosovës të jetë e drejta kompetente. Nëse mungon përcaktimi i së drejtës kompetente në një marrëveshje ndërkombëtare financiare, atëherë e drejta e zbatueshme e Kosovës që është në fuqi kur marrëveshja ndërkombëtare financiare në fjalë hyn në fuqi është e drejta kompetente lidhur me çdo çështje që rezulton nga kjo marrëveshje.

Neni 8 Këshilli për vëzhgimin e Marrëveshjeve Financiare Ndërkombëtare

8.1. Në propozim të Qeverisë, Kuvendi themelon Këshillin për vëzhgim, në emër të IPVQ-së, zbatimin e të gjitha Marrëveshjeve Financiare Ndërkombëtare, duke përfshirë edhe shfrytëzimin efikas, transparent dhe adekuat të të gjitha mjeteve që mbulohen ose që janë pranuar sipas marrëveshjeve në fjalë.

8.2. Këshilli për vëzhgim përbëhet nga një jurist me përvojë të konsiderueshme në marrëveshjet financiare ndërkombëtare apo komerciale, një revizor dhe një profesionist të prokurimit.

8.3. Këshilli i vëzhgimit është i autorizuar për sigurimin dhe kopjimin e cilësdo Marrëveshje Financiare Ndërkombëtare dhe të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me të ardhurat e mbuluara ose të pranuar në bazë të marrëveshjes në fjalë.

8.4. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga përfundimi i çdo tremujori kalendarik, Këshilli për vëzhgim do të përgadis dhe dorëzojë Qeverisë dhe Kuvendit raporte të rregullta mbi zbatimin e Marrëveshjeve Financiare Ndërkombëtare dhe shfrytëzimin e të gjitha të ardhurave që mbulohen ose që janë pranuar sipas marrëveshjeve në fjalë. Këshilli për vëzhgim është përgjegjës që menjëherë t'i raportojë Kuvendit dhe Qeverisë mbi çfarëdo aktivitete të parregullta në lidhje me marrëveshjet ose të ardhurat në fjalë.

Neni 9
Zbatueshmëria e Ligjit për Prokurimin Publik

9.1. Përveq nëse kushtet e specifikuara në nenin 3.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë (Ligji nr. 2003/17 i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2004/3 të 9 shtatorit 2004) janë të pranishme, të gjitha prokurimet që shfrytëzojnë të hyrat që mbulohen ose që janë pranuar sipas një Marrëveshje Financiare Ndërkombëtare duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me ligjin në fjalë.

9.2. Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë zbatohet edhe për zgjedhjen e cilit do entitet, institucion ose organizatë që ofron ose dëshiron të hyjë në një marrëveshje ndërkombëtare nëse entiteti ose institucioni në fjalë nuk është institucion i njohur ndërkombëtar financiar ose organizatë ndërkombëtare.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Kuvendi dhe me datën e shpalljes nga PSSP-ja .

Ligji Nr. 2004 / 14
06 Maj 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik Nexhat Daci